

POLITIKA PËR SIGURIMIN DHE MENAXHIMIN E CILËSISË

Preambula

Cilësia është në qendër të të gjitha aktiviteteve të Universitetit, por në veçanti fokusohet në ngritjen e standardeve, duke njohur arritjet dhe promovimin e një kulture pozitive dhe bashkëpunuese. Politika i mbulon të gjitha aktivitetet dhe palët e interesuara brenda institucionit siç i mbulon edhe aktivitetet e nën-kontraktuara nga jashtë.

Qëllimet janë që:

- të promovohet një kulturë në të cilën çdo fakultet, departament dhe person e sheh përmirësimin e cilësisë si përgjegjësi personale dhe kolektive;
- të zhvillohen strategji, politika, procedura, procese dhe iniciativa të cilat mbështesin një cikël efektiv të planifikimit, të implementimit, monitorimit dhe të përmirësimit - dhe të cilat e marrin parasysh kontekstin e jashtëm;
- të dizajnohen, të zhvillohen, të akreditohen dhe rregullisht të rishikohen, brenda dhe jashtë, të gjitha programet studimore në përputhje me standardet ligjore dhe me praktikatat më të mira në këtë fushë; pikësynimi ynë është që gjithashtu të sigurohemi se rezultatet e pritura nga të mësuarit dhe nga praktika e vlerësimit janë të përshtatshme për qëllimet tona;
- të përkrahen mësimdhënia dhe mësim-nxënia efektive e cila e kombinon qasjen që udhëhiqet nga hulumtimi, me studentët në qendër;
- të përdoren të dhëna, materiale tjera analitike dhe udhëzime për praktikën e mirë, për t'u siguruar se vlerësimet dhe vendimet janë të hapura, transparente dhe të mbështetura në mënyrë të qartë, me informacion relevant;
- të sigurohemi se raportet dhe vlerësimet e rëndësishme, duke përfshirë këtë politikë, janë publikuar;
- të mbrohet integriteti dhe liria akademike dhe të jemi vigjilent kundër mashtrimit akademik;
- të përdoren në mënyrë më të mirë standardet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me trendet në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, Standardet e Bolonjës dhe Udhëzimet (shih ESG 15, standard, pjesa 1.1.1);
- të ndahen dhe të shpërndahen informacionet dhe vendimmarrjet me të gjithë stejkholderët, me qëllim që të sigurohemi se janë përfshirë të gjithë, se arritjet njihen dhe shpërblehen dhe se do të ketë menaxhim efektiv të performancës, përfshirë edhe nënperformancën.

Përkufizimi

Kjo politikë e përshkruan sistemin e sigurimit dhe të menaxhimit të cilësisë në Universitet.

Kur krijohen, zhvillohen, implementohen, monitorohen cilësitë dhe kur bëhet vlerësimi i politikave, procedurave, strukturave dhe iniciativave të cilësisë, Universiteti do të ketë një qasje të integruar duke përfshirë këtu edhe sigurimin dhe menaxhimin e cilësisë së përcaktuar si vijon:

- Sigurimi i cilësisë fokusohet në çështjet akademike siç janë: hartimi i kurrikulave, akreditimi i programeve, rishikimi i brendshëm dhe i jashtëm, standardet akademike dhe etike. Këtu gjithashtu përfshihen mësimdhënia dhe nxënia dhe lidhen përafërsisht me ato shërbime të cilat drejtpërsëdrejti i mbështesin studentët, siç janë biblioteka, Shërbimi për studentë dhe Qendra e karrierës;
- Menaxhimi i cilësisë ka për objektiv zhvillimin efektiv, implementimin dhe monitorimin e politikave dhe të procedurave dhe cilësinë e seksioneve administrative dhe të shërbimeve.

Struktura e brendshme e sigurimit të cilësisë dhe rolet

Universiteti rregullisht e mirëmban dhe rishikon strukturën e brendshme të cilësisë për t'u siguruar se ajo është e përshtatshme për qëllimin (shih shtojcën x 1).

Kjo përfshin njësitë dhe rolet e mëposhtme:

- **Bordi i Universitetit** e miraton planin strategjik katërvjeçar në të cilin sigurimi dhe menaxhimi i cilësisë janë pjesë të rëndësishme. Ai ka përgjegjësinë përfundimtare për qeverisje. Gjithashtu ai e miraton Raportin e vetëvlerësimit trevjeçar.
- **Rektori** udhëheq me çështjet e sigurimit të cilësisë nëpërmjet **Komisionit për sigurimin dhe menaxhimin e cilësisë (KSMC)** dhe ai/ajo është përgjegjës ndaj Bordit. Komisioni përbëhet nga rektori, provosti, sekretari i përgjithshëm, prorektori për çështje akademike, këshilltari ekzekutiv për cilësi dhe dy koordinatorët me rotacion dyvjeçar nga komisioni për sigurimin e cilësisë, bashkëpunim dhe mirëbesim publik të fakultetit/qendrës. Mbështetja teknike sigurohet nga zyrtari për sigurimin e cilësisë. Komisioni takohet së paku dy herë gjatë vitit akademik për të pasur një vështrim dhe për të siguruar një drejtim të përgjithshëm.
- **Senati** – e emëron Komisionin e vetëvlerësimit dhe e aprovon raportin trevjeçar dhe progres raportin vjetor. Gjithashtu, Senati ka autoritet vendimmarrës dhe për këtë arsye mbikëqyr cilësinë edhe mbi një sërë çështjesh tjera akademike, siç janë miratimi i rregulloreve akademike studimore, konkursi për regjistrimin studentëve, akreditimi i programeve studimore dhe promovimi në titull mësimor-shkencor specifik.
- **Komisioni i vetëvlerësimit**, i cili është emëruar nga Senati, është përgjegjës për përpilimin e Raportit të vetëvlerësimit trevjeçar të gjerë të Universitetit në përputhje me kriteret dhe me procesin e kërkuar. Ky komision përdor edhe raportet e vetëvlerësimit të fakulteteve/qendrave dhe ofron përditësime vjetore të progresit.
- **Komisioni për sigurimin e cilësisë, bashkëpunim dhe mirëbesim publik** funksionon në çdo fakultet dhe në Qendrën e gjuhëve. Ekipi përfshin stafin, studentët dhe stejkholderët e jashtëm. Themelohet nga dekani/drejtori dhe miratohet nga Këshilli i fakultetit me mandat njëvjeçar. Ata i analizojnë të dhënat relevante, diskutojnë për

çështjet e cilësisë, për programet që do të akreditohen dhe sigurojnë këshilla, propozime dhe rekomandime për fakultetin, Senatin ose organet tjera të fakultetit ashtu siç është e nevojshme për përmirësim. Ata ofrojnë analiza reflektive, për ta përkrahur Planveprimin vjetor të njësisë, dhe për Raportin institucional trevjetor – Raportin e vetëvlerësimit.

- **Këshilli i fakultetit** – është organ profesional i fakultetit dhe këshillëdhënës për dekanin, çështjet akademike dhe ato të sigurimit të cilësisë;
- **Kolegjiumi** përbëhet nga drejtorët/përgjegjësit e shërbimeve administrative. Në këtë organ diskutohen çështje të rëndësishme të cilësisë në mënyrë të rregullt, nën drejtimin e sekretarit të përgjithshëm.
- **Zyra për sigurimin e cilësisë** koordinon funksionimin e aktiviteteve dhe proceseve të sigurimit të cilësisë, anketat e vlerësimit nga studentët dhe të aktiviteteve qendrore të trajnimit. I mbështet ekipet e cilësisë/Bordin për bashkëpunim dhe mirëbesim publik dhe komisionet qendrore, udhëheq me iniciativat specifike të cilësisë, sigurohet që informacioni të shpërndahet dhe kultura pozitive e cilësisë të promovohet nëpërmjet një sërë mekanizmash të komunikimit.
- **Ekipi ISO** emërohet nga sekretari i përgjithshëm. Punon për krijimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të menaxhimit të cilësisë në Universitet.
- **Kontributi i studentëve për rritjen e cilësisë** – Përfaqësuesit e studentëve marrin pjesë në Bordin e Universitetit, në Senat, në Këshillin e rektorit, në Këshillin e fakultetit, ekipet e cilësisë/Bordin për bashkëpunim dhe mirëbesim publik dhe rregullisht ftohen për të siguruar të dhëna dhe monitorim të aktiviteteve të Universitetit dhe sesione të trajnimit.
- **Ombudspersoni studentor** - zgjidh çështjet e studentëve të cilat nuk janë zgjidhur me mjete joformale.

Vendosja dhe ruajtja e standardeve

Të gjitha programet janë të dizajnuara dhe të (ri) akredituara në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë, Kornizën kombëtare të arsimit dhe procesin e menaxhuar nga Bordi Nacional i Akreditimit dhe Vlerësimit. Në mënyrë institucionale, ky proces mbikëqyret nga Pro-rektori për çështje akademike. Dekanati i fakultetit është përgjegjës për koordinimin e dizajnit apo të ri-akreditimit të programeve. Ky proces përfshin edhe Bordet e fakulteteve për bashkëpunim dhe mirëbesim publik, të cilat përbëhen nga stejkholderët e jashtëm, studentët dhe nga stafi. Kjo ka për qëllim që të sigurojë një vlerësim objektiv të caqeve dhe objektivave të programeve në lidhje me tregun e punës dhe me përfitimin shoqëror.

Universiteti e garanton lirinë akademike për anëtarët e fakulteteve në të dyja rrafshet - hulumtim dhe mësimdhënie. Me qëllim që të mbështeten standardet e përgjithshme të cilësisë së notimit/vlerësimit, çdo fakultet ka krijuar një arkiv të provimit i cili monitorohet për përputhshmërinë dhe për cilësinë. Fakultetet inkurajohen ta praktikojnë monitorimin dhe vlerësimin e kryqëzuar nga kolegët. Anëtarët e fakultetit gjithashtu nxiten për t'i përdorur rubrikat për vlerësim të provimeve.

Rregulloret për ciklet e studimit, formulari për raportim të plagjiaturës dhe rregullorja për masa disiplinore japin udhëzime të qarta lidhur me ruajtjen e integritetit akademik. Rregullorja për hulumtim shkencor, rregullorja për promovim të titullit shkencor dhe zbatimi i bazës së të dhënave për hulumtim, në kombinim me rregulloret e lartpërmendura, japin të njëjtat udhëzime për stafin.

Një analizë vjetore e të dhënave nga notimi/vlerësimi kryhet si pjesë e monitorimit të cilësisë.

Sigurimi i cilësisë institucionale

Me qëllim që të zhvillojë një kulturë pozitive të cilësisë, t'u përgjigjet ndryshimeve dhe nevojës për përmirësim, Universiteti përdor një gamë të mekanizmave të brendshëm vlerësues, duke i përfshirë, por duke mos u kufizuar, në pikët në vijim:

- Cilësia e mësimdhënies dhe nxënies ruhet dhe zhvillohet përmes skemës së vëzhgimit të mësimdhënies, vlerësimeve vjetore të studentëve, vlerësimit individual të stafit dhe mundësive për zhvillim profesional.
- Procedura vjetore për vlerësimin e stafit është një vegël e rëndësishme për vlerësimin e performancës individuale, si bazë për rinovim të kontratës, për përparim dhe promovim. Kjo është mbështetur nga rregulloret dhe procedurat për kompetencë, për ankim, për orarin e punës dhe për masa disiplinore.
- Universiteti operon me kontratën për menaxhim të performancës për stafin akademik, lidhur me rezultatet e hulumtimit. Ekziston edhe një skemë vjetore për shpërblim të kontributit të dhënë në nxënie dhe mësimdhënie.
- ISO standardet për politikat dhe procedurat mbikëqyren nga ekipet e auditimit të brendshëm të trajnuar në baza vjetore dhe miratohen nga agjencitë e jashtme për ISO vlerësim.
- Financat e Universitetit janë të monitoruara nga auditimi i brendshëm dhe nga një zyrë e auditimit të jashtëm e cila është akredituar në shkallë ndërkombëtare.
- Niveli i plotësimit të normave të anëtarëve të stafit dhe të studentëve shqyrtohet nëpërmjet vlerësimit nga studentët dhe nëpërmjet anketave për nivelin e plotësimit të normave nga stafi. Universiteti operon procedurën e ankimit nga studentët dhe mbështet Ombudspersonin studentor në punën e tij.
- Në nivel institucional dhe në nivel të njësive, njësitë akademike dhe administrative u japin përparësi dhe i artikulojnë anët e forta, të dobëta dhe prioritetet në plan-veprimet të cilat udhëhiqen gjerësisht, shpërndahen dhe përdoren në mënyrë aktive.
- Universiteti ofron trajnime të rregullta të stafit, të përgjithshme dhe të veçanta, dhe mbështet stafin me kërkesa për kualifikim, publikim të hulumtimit dhe mobilitetit.
- Ka nisma të cilësisë të cilat fokusohen në një aspekt të veçantë, siç është vlerësimi i studentëve apo zhvillimi i sistemeve elektronike.

Sigurimi i jashtëm i cilësisë

Me qëllim që të zhvillojë një kulturë të cilësisë, Universiteti përshtatet me kërkesat përkatëse ligjore dhe përdor një gamë të mekanizmave të jashtëm vlerësues për ta zhvilluar praktikën e shkëlqyer, duke i përfshirë, por duke mos u kufizuar në pikët në vijim:

- Në përputhshmëri me Ligjin për arsim të lartë dhe ligjet tjera relevante. Kjo përfshin bashkëpunimin me Ministrinë e Arsimit dhe agjencitë që kanë të bëjnë me këtë veprimtari dhe me Bordin nacional të akreditimit dhe të vlerësimit, me theks të veçantë në përdorimin e tyre, me qëllim të zgjerimit të praktikës së mirë;
- Vlerësimin e jashtëm përmes agjencive të akredituara të jashtme, si pjesë e Asociacionit të Universiteteve Evropiane (*European Universities Association EUA*) i cili siguron vlerësim objektiv të jashtëm për një cikël katërvjeçar në një vlerësim fillestar dhe pasues (vlerësimi fillestar dhe pasues tani kanë përfunduar);
- Vizitat vjetore nga kampioni (ët) i cilësisë i cili të paktën dy herë në vit siguron kontrolle dhe rishikime me rekomandime për përmirësime dhe veprime pasuese;
- Vlerësuesit e jashtëm të programeve studimore bëjnë rishikimin e programeve për një cikël 4-6 vjeçar me qëllim që t'u sigurojnë fakulteteve/njësive akademike analiza dhe rekomandime për ta mbështetur zhvillimin e tyre;
- Standardet ISO të jashtme aplikohen me rivlerësimin vjetor, në mënyrë që ta verifikojnë efektivitetin e politikave dhe të procedurave;
- Pjesëmarrje në projektet e HEAL, në konferenca dhe forume të tjera dhe shqyrtim aktiv dhe të rregullt të trendeve dhe të praktikave më të mira të promovuara në shkallë ndërkombëtare..

Informim i stafit, studentëve dhe stakeholderëve

Universiteti siguron që informacioni i publikuar në lidhje me dispozitat e tij është i përshtatshëm për qëllimin që ka, është i arritshëm, i besueshëm dhe bëhet në të gjitha gjuhët që përdoren në nivel të Universitetit. Ky proces mbikëqyret nga Zyra për informim dhe promovim. Të dhënat relevante rishikohen rregullisht me qëllim përmirësimi.

Ndikimi i deklaratës për barazi

Kjo rregullore zbatohet në përputhje me parimet e përkushtimit të Universitetit për barazi dhe diversitet, të përmbledhura në Deklaratën e misionit. Kjo përfshin trajtim të drejtë dhe të barabartë për të gjithë të punësuarit dhe shfrytëzuesit e shërbimeve të Universitetit, respektimin e diversitetit dhe zbatimin e politikës së Universitetit për përdorimin fleksibël të gjuhëve.

Politika për mundësi të barabarta dhe Rregullorja për masa disiplinore për stafin dhe për studentët e mbështesin Universitetin në trajtimin e diskriminimit, në sigurimin e respektit, të mundësive të barabarta dhe të lirisë akademike.

Dispozitat përfundimtare

Kjo politikë për sigurimin dhe menaxhimin e cilësisë shqyrtohet si pjesë e procesit të vetëvlerësimit në baza tre vjetore nga ana e Komisionit për sigurim dhe menaxhim të cilësisë dhe nga ekipet e cilësisë së fakulteteve/departamenteve.

Shtojca 1 Struktura e cilësisë